

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 5
24.01.2014

NR. VENDIMI 15
24.07.2014

Vendim

“Ne emer te Republikes”

Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane
ne trup gjykues te perbere prej gjyqtareve:

Kryesuese : Iliriana OLLDASHI
Anetar : Gurali BRAHIMLLARI
Anetar : Luan HASNEZIRI

Asistuar nga sekretari gjyqesor **Besjan Hysi**, sot ne daten **24/07/2014**,
ora 11:20 ne Tirane, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore kerkesen penale **nr.**
5 qe i perket :

Paditesi: Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te
Renda Tirane, perfaqesuar ne gjykim nga prokurori **Edvin**
KONDILI.

I padituri: **O.T., i biri i K. dhe i Z., i datelindjes xxx**, lindur ne Tirane
dhe banues ne xxx, Rruga “xxx”. P. nr. xx., aktualisht vuan
denimin prane I.E.V.P xxx.
Perfaqesuar ne gjykim nga perfaqesuesi me deklarim
dhe njekohesisht mbrojtës i tij, av. A.T., Anetar i Dhomes
se Avokatise xxx, me nr. License profesionale xxx.

Me objekt: **Konfiskimin e pasurise**

Baza Ligjore: **Ligji nr. 10192 date 03/12/2009 “Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimin te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese Kunder pasurise”.**

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te zhvilluar ne prani:

- te prokurorit Edvin Kondili qe kerkoi: pranimin e kerkesepadise duke:

1-Konfiskuar shumen monetare te shtetasit O.T., prej xxx euro dhe xxx leke.

2-Per administrimin e kesaj pasurie te ngarkohet z.Kleant Xholi, i cili eshte administrator prane Agjencise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.

-ne pranine e perfaqesuesit dhe mbrojtetit te te paditurit O.T., av. A.T. qe kerkoi: Rrezimin si te pabazuar te kerkesepadise dhe kthimin e shumave monetare te sekuestruara, te paditurit.

kjo gjykate pasi degjoi kerkimet e paleve ndergjyqese dhe shqyrtoi provat e ketij gjykimi :

VEREN se :

Prokuroria per Krime te Renda Tirane ka paraqitur para kesaj gjykate kerkesepadine me objekt konfiskimin e pasurise se te paditurit O.T. dhe konkretisht te nje shume monetare prej **prej xxx euro dhe xxx leke.**

Kjo kerkesepadi eshte paraqitur ne daten xxx pas dates xxx qe eshte data e marrjes se vendimit nr. xx te kesaj gjykate per vendosjen ne mase sekuestimi te pasurise objekt gjykimi (i cili ende nuk eshte ekzekutuar).

Kerkesa per sekuestrimin e pasurise se shtetasit O.T. nga Prokuroria per Krime te Renda eshte bere mbi pretendimin se T. eshte subjekt i hetimit pasuror sipas ligjit **nr. 10192 date 03/12/2009 “Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimin te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese Kunder Pasurise”**, pasurite e zoteruara nuk i pergjigjen

nivelit te te ardhurave dhe fitimeve te tij, si dhe ekziston rreziku, qe keto pasuri te humbasin, apo tjetersohen.

Keto veprime jane ndermarre nga Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, pasi me date **xxx**, ka regjistruar procedimin penal Nr.xx, per vepren penale te parashikuar nga neni **283/a/2** i Kodit Penal ne ngarkim te te pandehurve ***O.T., D.L. etj.***

Nga hetimet e kryera, ka rezultuar se shtetasit O.T., D.L. dhe A.C. jane implikuar ne ngjarjen e dates **xxx** ku ne xxx eshte arrestuar shtetasi K.K. dhe ne kamionin qe ai drejtonte eshte gjetur dhe sekuestruar nje sasi lende narkotike prej xxx kg e llojit Cannabis Sativa.

Hetimet e Prokurorise per Krime te Renda kane filluar pas mberritjes se materialeve per kete ngjarje kriminale nga autoritetet xxx te drejtesise si rezultat i te cilave eshte bere rregjistrimi i emrave te O.T., D.L. dhe A.C. si persona te cileve ju atribuohet vepra penale e “Trafikimit te narkotikeve ” e kryer ne bashkepunim e parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal.

Ne funksion te ketij procedimi eshte vendosur dhe masa e sigurimit personal “arrest ne burg” ndaj shtetasit O.T.. Ne momentin ekzekutimit te kesaj mase sigurimi, gjate kontrollit personal shtetasit **O.T. i jane gjetur dhe sekuestruar per llogari te procedimit penal nje shume monetare prej xxx euro dhe xxx leke** te cilat jane depozituar ne Banken xxx me nr. Llogarie xxx dhe ne Banken xxx me nr. Llogarie xxx.Kjo shume monetare eshte sekuestruar dhe ne funksion te procedimit penal.

Me date xxx, Prokuroria per Krime te Renda, ne baze te akteve te procedimit penal nr. xx te vitit xxx, ka regjistruar procedimin pasuror nr.xx.

Si rezultat i hetimit pasuror dhe duke pretenduar se pasuria prej **prej xxx euro dhe xxx leke qe i eshte gjetur ne momentin e arrestimit te denuarit O.T. nuk ka prejardhje te ligjshme, Prokuroria per Krime te Renda mbi keto argumenta kerkoi konfiskimin e kesaj pasurie.**

Mbrojtësi i të paditurit av. A.T., i cili sipas nenit **21/3 të ligjit nr. 10192 date 03/12/2009**, ka bërë e provës, për t'i vërtetuar kësaj gjykate se pasuria për të cilën kërkohet konfiskimi është e fituar në mënyrë të ligjshme i paraqiti kësaj gjate disa akte që provonin se nga dhjetori i vitit xxx deri në xxx i padituri O.T. ka punuar si emigrant në xxx, në xxx dhe ka fituar të ardhura të ligjshme si dhe ka shitur edhe një automjet.

Për keto të ardhura gjykata caktoi dhe një ekspert kontabel i cili llogariti përafërsisht (**sepse ju referua të dhënave të shtetit italian për shtetasit italian, jo për një rast specifik dhe jo për një emigrant**) se shuma e kursyer nga të ardhurat e krijuara në mënyrë të ligjshme nga i padituri O.T. dhe nëna e tij është në masën **xxx euro**.

Mbi keto të dhëna të aktit të ekspertimit kontabel i padituri nëpërmjet mbrojtësit të tij pretendoi rrezimin e kërkesës për konfiskim të shumave monetare prej **xxx euro dhe xxx leke**, pasi niveli i të ardhurave dhe fitimeve të ligjshme të të paditurit justifikojnë jo vetëm shumën që kërkohet të konfiskohet, por shumë më tepër se kaq.

Gjykata vlerëson si të drejtë dhe të bazuar në ligj kërkesëpadinë e Prokurorisë për Krime të Renda, e cila duhet të pranohet duke vendosur konfiskimin e pasurisë së shtetasit O.T. në vlerën monetare prej xxx euro dhe xxx leke sepse:

Shtetasi shqiptar O.T. është hetuar dhe dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni **283/a/2** i Kodit Penal.

Pra nisur nga lloji i veprës për të cilën është hetuar dhe dënuar dhe ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm të bazuar (tek indicjet) tek provat në rastin konkret, se shtetasi O.T. është i përfshirë në një veprimtari kriminale të trafikimit të lendeve narkotike, ai është subjekt ndaj pasurive të të cilit zbatohen dispozitat e ligjit **nr. 10192, date 03/12/2009** "Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese Kunder Pasurisë", sipas parashikimit të nenit **3/1 pika ç** e këtij ligji.

Shuma monetare prej xxx euro dhe xxx leke të paditurit O.T. i është gjetur në date **xxx** gjate kontrollit personal të kryer në momentin e ekzekutimit të masës së sigurimit "arrest në burg", të vendosur ndaj

tij ne nje situate teper specifike, menjehere pas kthimit te tij nga shteti i xxx, levizje qe provohet edhe me te dhenat e sistemit TIMS.

Per keto shuma monetare, i padituri O.T. nuk ka bere asnje deklarim ne piken e kalimit kufitar ndershteteror xxx- xxx per shumat e disponuara, arsyet e disponimit te tyre dhe dokumentacionin qe vertetonte origjinen e tyre (dhe as ne kete gjykim nuk provai te kunderten).

Edhe ne kete gjykim ku i padituri O.T. **kishte barren e proves**, kjo gjykate vlereson se nuk e permbushi ate, madje jo vetem qe nuk paraqiti asnje prove te vetme qe te ligjeronte posedimin prej tij ne daten 31/05/2012 te kesaj vlere monetare, realisht te konsiderueshme per tu mbajtur cash me vete, por as edhe nje rrethane justifikuese per kete moment.

Kjo gjykate vlereson se edhe pse mbrojtja ne kerkimin e saj per rrezimin e kerkeses per konfiskim i referohet nenit 24 te ligjit **nr. 10192, date 03/12/2009** duke pretenduar se qe te pranohet kerkesa duhet te plotesohen te gjitha kushtet e kerkuar nga kjo dispozite, ben nje interpretim dhe lexim te gabuar te saj.

Keshtu neni 24 i ligjit te ashtuquajtur “ligji-antimafia” parashikon se:

Gjykata vendos konfiskimin e pasurise kur plotesohen te gjitha keto kushte:

- 1- Kur ka dyshime te arsyeshme, bazuar ne indicje per pjesemarrje te personit ne veprimtari kriminale te parashikuara ne nenin 3 te ligjit antimafia (rrethane e provuar qe nuk kontestohet as nga i padituri dhe mbrojtja e tij);***
- 2- Kur nuk provohet se pasuria ka prejardhje te ligjshme (qe eshte rasti objekt gjykimi) apo personi nuk justifikon zoterimin e pasurive ose te te ardhurave qe nuk i pergjigjen dukshem nivelit te te ardhurave, fitimeve apo veprimtarive te ligjshme, te deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre; dhe***
- 3- Kur pasuria eshte drejteperdrejte ose terthorazi ne zoterim te pjesshem apo te plote te personit (eshte e provuar qe eshte poseduar plotesisht nga i padituri ne momentin e kontrollit personal).***

Ne rastin objekt gjykimi per te paditurin O.T. dhe te vlerave monetare per te cilat kerkohet konfiskimi plotesohen te tre keto kushte, pra ai eshte subjekt i

ligjit “antimafia” nuk provon qe vlerat monetare te kene prejardhje te ligjshme dhe keto vlera **prej xxx euro dhe xxx leke kane** qene ne posedimin e plote te te paditurit ne momentin qe i eshte bere kontrolli personal i tij.

Lidhur me pretendimin e mbrojtjes se nuk plotesohet **pika b e nenit 24** te ligjit gjykate vlereson se pikerisht ne kete pike te dispozites behet lexim i gabuar i saj nga mbrojtja.

Pika **b nenit 24** te ligjit parashikon dy kushte alternative qe lidhen mes tyre me lidhesen veçuese **apo (qe gramatikisht interpretohet qe mjafton ne alternative njeri prej te dyve)** dhe nje kusht detyrues qe lidhet me lidhezen bashkuese **dhe (qe gramatikisht interpretohet qe duhet te shoqeroje ne çdo rast dy alternativat e para).**

Kete interpretim gramatikor te bere me siper, kjo gjykate e arsyeton me thjesht si me poshte:

Per nje pasuri qe kerkohet konfiskimi pika b e nenit 24 te ligjit kerkon qe :

- 1- nuk provohet se pasuria ka prejardhje te ligjshme dhe as nuk justifikohen prej tyre (subjekteve):
- 2- nuk justifikon zoterimin e pasurive ose te te ardhurave qe nuk i pergjigjen dukshem nivelit te te ardhurave, fitimeve apo veprimtarive te ligjshme, te deklaruarra dhe as nuk justifikohen prej tyre (subjekteve).

Neni 24 i ligjit ka parashikuar keto raste alternative sepse eshte nje dispozite qe u referohet te gjitha rasteve, por ne çdo gjykim gjykata do t'i referohet rastit konkret ne perputhje me parashikimet ligjore te nenit 24 te ligjit.

Ne çeshtjen objekt gjykimi, situata e te paditurit dhe pasurise qe i eshte gjetur atij eshte sepcifike dhe kerkon aplikimin konkret te pikes b te ligjit qe ne çeshtjen Tabako eshte **nuk provon se pasuria ka prejardhje te ligjshme dhe as nuk justifikohet prej tij arsye mbi te cilat kjo gjykate vendos konfiskimin e saj.**

Per ekzekutimin e ketij vendimi, ne perputhje me nenin 14 te ligjit **nr. 10192, date 03/12/2009** urdherohet Zyra e Permbarimit Gjyqesor Tirane, ndersa per administrimin dhe perdorimin e llogarive bankare ngarkohet **z. Kleant**

Xholi, i cili eshte administrator prane Agjencise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.

Mbi arsyetimin e pasqyruar me siper ne baze te nenit 212 e vijues te K.Pr.Civile dhe neneve 24 e vijues te ligjit **nr. 10192, date 03/12/2009** "Per parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise", kjo gjykate pasi formoi bindjen dhe ne mbeshtetje te provave te shqyrtuara ne kete gjykim:

V E N D O S I

Pranimin e kerkeses duke konfiskuar pasurite e meposhtme te shtetasit O.T.:

1. Shumen prej xxx euro te depozituar ne Banken Intesa San Paolo me nr. Llogarie xxx.
2. Shumen prej xxx leke te depozituar ne Banken xxx me nr. Llogarie xxx.
3. Per Administrimin dhe perdorimin e **llogarise bankare** ngarkohet **z.Kleant Xholi**, i cili eshte administrator prane Agjencise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.
4. Per ekzekutimin e ketij vendimi ngarkohet Zyra e Permbarimit - xxx.
5. Urdherohet sekretaria gjyqesore e kesaj gjykate te dergoje menjehere kopje te ketij vendimi ne institucionet e mesiperme.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit per Krime te Renda brenda afatit ligjor, 15 dite nga e nesermja e shpalljes.

U shpall sot ne Tirane, me date 24/07/2014, ora 11.30.

Sekretar

Besjan HYSI

Gjyqtare

Iliriana OLLDASHI

